



VENDIM

Nr. 148, Datë 30.09.2016

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SH.A PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT NR. 131 DATË 15.08.2016 TË BORDIT TË ERE “MBI
NDËRPRERJEN E PROCEDURËS SË SHPALLUR NGA SHOQËRIA
KESH SH.A. “FTESE PËR SHPREHJE INTERESI PËR
MARRËVESHJEN KUADËR PËR DEPOZITIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i ERE-s dhe nenit 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtorite teknike, në lidhje me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a për rishikim e vendimit nr. 131 datë 15.08.2016 të Bordit të ERE “Mbi ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH sh.a. “Ftese për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria KESH sh.a. ka marrë dijeni për vendimin e ERE nr. 131 datë 15.08.2016 nëpërmjet shkresës së ERE nr.626 prot datë 22.08.2016.
- Shoqëria KESH sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën nr 7376/1 datë 31.08.2016, protokolluar me tonën nr 626/1 datë 01.09.2016 për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 131 datë 15.08.2016 “Ftese për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”
- Shoqëria KESH sh.a. ka depozituar ne vijim në ERE shkresën nr 7376/2 date 27.09.2016 “Në vijim të kërkesës drejtuar Bordit të

ERE me shkresën 7376/1 datë 31.08.2016 me objekt “Kërkesë për rishikimin e vendimit nr 131, datë 15.08.2016”

- Pika 5 e nenit 16 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe Neni 16 i “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016”, parashikon se: *Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.*
- Kërkesa e KESH sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 131 datë 15.08.2016, është depozituar jashtë afatit të parashikuar më sipër.
- Shoqëria KESH sh.a ka paraqitur në ERE si prova të reja, si më poshtë:
 - ✓ Procedura e filluar dhe shpallur në faqen zyrtare të KESH sh.a “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”, është finalizuar nga ana e KESH sh.a. me kontratën nr. 6549 Prot datë 27.07.2016.
 - ✓ Në zbatim të Vendimit nr. 131 datë 15.08.2016 të Bordit të ERE, KESH sh.a. ka pezulluar veprimet e mëtejshme për zbatimin e kontratës nr. 6549 Prot datë 27.07.2016.
 - ✓ Procesi i depozitimit të energjisë elektrike, do të garantonte të ardhura për KESH sh.a. në një vlerë tregu prej 5 milionë Euro për 6-mujorin e parë të vitit 2016.
- KESH sh.a. në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, duke marrë në konsideratë interesin publik për garantimin e furnizimit me energji elektrike, si dhe shfrytëzimin eficient të energjisë elektrike, në konsultim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, ti japë zgjidhje situatës së menaxhimit të energjisë

elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha me rregullimin në legjislacionin mbështetës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e KESH sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 131, datë 15.08.2016 mbështetur në pikën 5 të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe në nenin 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, depozituar jashtë afatit të parashikuar në ligj.
2. KESH sh.a. në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, për qëllime të interesit publik, garantimit të furnizimit me energji elektrike si dhe shfrytëzimin eficient të energjisë elektrike, në konsultim me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë, të adresojë menaxhimin e energjisë elektrike mbështetur në legjislacion përkatës pas përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik, të parashikuar në ligj.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a, Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI